



RAPORTI VJETOR 2023

PËRMBAJTJA

1.	QËLLIMI I RAPORTIT VJETOR _____	3
2.	METODOLOGJIA _____	4
3.	ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E N.P.L “KASTRIOTI” SH.A _____	5
4.	STRUKTURA ORGANIZATIVE _____	6
5.	KONTRATAT E LIDHURA JANAR – DHJETOR 2023 _____	7
6.	RAPORTI I PUNËS NGA MENAXHERËT E KONTRATAVE _____	8
6.1	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit _____	9
6.2	Drejtoria e Arsimit _____	11
6.3	Drejtoria e Shëndetësisë _____	13
6.4	Drejtoria e Kulturës _____	15
6.5	Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave _____	17
6.6	Mirëmbajtja dhe Pastrimi i Objekteve Komunale në Obiliq _____	18
6.7	Ofrimi i Shërbimeve të Recepcionit në Objektet Komunale _____	19
6.8	Renovimi i Objekteve Shkollore _____	20
6.9	Mirëmbajtja e Ndriçimit Publik _____	22
6.10	Dekorimi i qytetit të Obiliqit gjatë Festave të Fundvitit _____	24
6.11	Aktivizimi-Ndezja, Mbikëqyrja dhe Pastrimi i Kaldajave për Ngrohjen e Objekteve Shkollore në Komunën e Obiliqit. _____	25
6.12	Mirëmbajtje dhe Pastrimin e Poligonit të Shenjëtarisë Katana _____	25
7.	RAPORTI VJETOR I SEKRETARIT TË NDËRMARRJES _____	26
8.	RAPORTI VJETOR I PUNËS SË BURIMEVE NJERËZORE _____	28
9.	RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRTARIT LIGJOR _____	30
10.	RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS PËR PROKURIM _____	31
11.	RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN FISKAL 2023 _____	33
11.1	Pasqyra e arkëtimit të të hyrave nga shërbimet Janar – Dhjetor 2023 _____	34
11.2	Pasqyra e shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2023 _____	34
	PËRFUNDIM _____	36

1. QËLLIMI I RAPORTIT VJETOR

Me anë të Raportit Vjetor për vitin 2023, Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti dhe të punësuarit e tjerë në ndërmarrjen publike “Kastrioti” Sh.A do të paraqesin të gjitha faktet reale që e kanë shoqëruar punën e ndërmarrjes prej datës 01.01.2023 deri 31.12.2023.

Ky raport shërben për të vënë në dijeni me të gjitha aktivitetet që janë ndërmarrë gjatë vitit.

Po ashtu përmes këtij raporti menaxhmenti synon të arrijë transparencë maksimale duke publikuar të gjitha veprimet që e kanë shoqëruar veprimtarinë e punës së ndërmarrjes gjatë vitit 2023, e në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.



2. METODOLOGJIA

Raporti është përpiluar duke marrë për bazë raportet paraprake, si dhe:

- Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr.03/L-087 së bashku me plotësim ndryshimet e tij;
- Ligji për Menaxhimin e financave publike (2008/03/L-048,2012-04/L-116);
- Ligji për Shoqëritë Tregtare (2011-04/L-006);
- Ligji i punës (03/L-212-2010);
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (03/L-172);
- Ligji për Festat Zyrtare (03/L-064).

Me qëllim që raporti të jetë më i thjeshtë dhe më i kuptueshëm për të gjithë, është ndërtuar duke përfshirë pjesë tekstuale-përshkruese me pjesë të tabelave dhe fizuelizim përmes fotografive.

Në raport janë bërë edhe krahasimet me vitin paraprak dhe me Planin e biznesit për vitin 2022.

Raporti është përmbledhje e raporteve të zyrtareve të lartë dhe departamenteve në N.P.L “Kastrioti” SH.A.



3. ROLI DHE PËRGJEGJËSITË E N.P.L “KASTRIOTI” SH.A

N.P.L ”Kastrioti” Sh.A në Obiliq funksionon në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës së Obiliqit Nr:1-345 të datës 30.11.2020 dhe certifikatës së biznesit të regjistruar, me nr. Biznesi 811838509 pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë me datë 22.07.2021 dhe plotësim ndryshimin e Statutit të kësaj ndërmarrje të aprovuar nga Bordi i kësaj Ndërmarrje me datë 11.08.2022.

Sipas Statutit Ndërmarrja N.P.L “Kastrioti” SH.A ka këto përgjegjësi:

- Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve (mjedisit);
- Aktivitetet e tjera të pastrimit të ndërtesave, objekteve industriale;
- Aktivitetet e tjera të pastrimit;
- Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor;
- Punimet hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit;
- Kultivimi i bimëve të tjera një vjeçare;
- Kultivimi i bimëve të tjera shumë vjeçare;
- Marrja dhe dhënia me qira e makinerisë dhe pajisjeve bujqësore;
- Punime suvatimi;
- Demolimi i objekteve;
- Përgatitja e vend punishtes;
- Instalime elektrike;
- Aktivitetet përkatëse të kombinuara.



4. STRUKTURA ORGANIZATIVE

Në përputhje me ligjet në fuqi, N.P.L “Kastrioti” Sh.A udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv i cili i përgjigjet drejtpërdrejt Bordit të Drejtorëve. Bordi i Drejtorëve i raporton Komisionin Komunal të Aksionarëve të caktuar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit dhe Kryetari i Komunës.

Komisioni Komunal i Aksionarëve i emëruar nga Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit ka aprovuar Statutin e Ndërmarrjes Publike Lokale “Kastrioti” Sh.A datë 19.07.2021 e duke u bazuar në vendimin për themelimin e kësaj ndërmarrje, në bazë të nenit 130 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr:03/L-087 dhe plotësim-ndryshim i Ligjit Nr. 04/L-111, Bordi i Drejtorëve e përgatitë dhe miraton Rregulloren mbi Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr:prot-09/2021 datë 12.08.2021 dhe përcakton këtë strukturë organizative.



5. KONTRATAT E LIDHURA JANAR – DHJETOR 2023

Më poshtë janë paraqitur të gjitha kontratat për ofrimin e shërbimeve të cilat NPL Kastrioti Sh.A i ka të lidhura me operatorë publikë dhe privatë.

- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Mirëmbajta e Hapësirave Publike) Nr.01/23 datë 28.04.2023 e lidhur me Komunën e Obiliqit.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Mirëmbajtja dhe Pastrimi i Objekteve Komunale në Komunën e Obiliqit) Nr.02/23 datë 28.04.2023 e lidhur me Komunën e Obiliqit.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Ofrimi i Shërbimeve të Receptionit në Objektet Komunale) Nr.03/23 të datës 28.04.2023 e lidhur me Komunën e Obiliqit.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Renovimi i Objekteve Shkollore) Nr.04/23 datë 01.06.2023 e lidhur me Komunën e Obiliqit.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Mirëmbajtja e ndriçimit Publik në tërë territorin e komunës së Obiliqit Nr. 05/23 datë 21.08.2023 dhe aneks kontrata me nr. 05-1/23 të datës 01.12.2023 e lidhur me Komunën e Obiliqit.
- Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve - Mirëmbajtje dhe Pastrimin e Poligonit të Shenjëtarisë Katana, me nr. prot. 883/23 datë 08.09.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Dekorimi i qytetit të Obiliqit Gjatë Festave të Fund Vitit me nr. 06/23 datë 26.10.2023 e lidhur me Komunën e Obiliqit.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) – Aktivizimi - Ndezja, Mbikëqyrja dhe Pastrimi i Kaldajave për Ngrohjen e Objekteve Shkollore në Komunën e Obiliqit me nr.07/23 datë 09.11.2023 e lidhur me Komunën e Obiliqit.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Mirëmbajta e Hapësirave Publike në territorin e komunës së Obiliqit me nr. 08/23 të datës 01.12.2023 (shërbimet më këtë kontratë janë ri-kontraktuar për shkak të shpenzimit të kontratës me nr.01/23 e cekur më lart) e lidhur me Komunën e Obiliqit.

6. RAPORTI I PUNËS NGA MENAXHERËT E KONTRATAVE

Duke u bazuar në Kontratën për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Mirëmbajta e Hapësirave Publike) Nr.02/22 datë 15.03.2022, Kontratën për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Mirëmbajta e Hapësirave Publike) Nr.02/23 datë 28.04.2023, dhe Kontratën për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Mirëmbajta e Hapësirave Publike në territorin e komunës së Obiliqit me nr. 08/23 të datës 01.12.2023 për vitin 2023 kemi ofruar shërbime në mirëmbajtjen e hapësirave publike për Komunën e Obiliqit përkatësisht për këto drejtori.

- Drejtorinë për Mbrojtje të Mjedisit;
- Drejtorinë e Arsimit;
- Drejtorinë e Shëndetësisë;
- Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe
- Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave.



6.1 Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit

Gjatë vitit 2023 duke u bazuar në kërkesat e menaxherit të kontratës kemi kryer këto shërbime në sheshet, parqet dhe rrugët e komunës së Obiliqit. sipas pozicioneve të kontratës:

Nr.	Përshkrimi i pozicionit:	Totali vjetor (2023) në njësi
1	Largimi i mbeturinave nga sipërfaqet e gjelbëruara dhe nga shportat e vendosura në ato sipërfaqe dhe bartja deri në deponi	931,006 m ²
2	Kositja e barit me makina kositëse, grabujimi i barit të kositur dhe bartja deri në deponi	294,806 m ²
3	Fshirja dhe larja e kubzave	9,025 m ²
4	Krasitja e drunjve dekorativ	800 copë
5	Krasitja e degëve të thara të drunjve dhe transporti i degëve deri në deponi	62 copë
6	Hapja e gropave 60x60x80 cm dhe mbjellja e fidanëve-gjetherënëse dhe gjethembajtëse dhe për nevoja tjera	80 copë
7	Prerja dhe largimi i drunjve të lartë të cilët paraqesin rrezik, gjatësi 15m-30m	2 copë
8	Kositja e barit me sillt (makinë kositëse me penj)	10,3741 m ²
9	Ujitja e drunjve me cisterne	824 copë
10	Gëlqerosja e trupit të drunjve dekorativ	463 copë
11	Prerja e kaqubëzave të degraduara të lartësisë prej .05m-1.5m dhe bartja deri në deponi	250 copë
12	Mirëmbajtja e ulëseve (pastrimi, ngjyrosja me ngjyrë të njëjte me atë ekzistuese, ankerimi), aktivitetet e lartcekura bëhen sipas kërkesës së kontraktuesit.	78 copë
13	Mirëmbajtja e shportave (pastrimi, ngjyrosja me ngjyrë të njëjte me atë ekzistuese, ankerimi), aktivitetet e lartcekura bëhen sipas kërkesës së kontraktuesit.	45 copë
14	Pastrimi i gjetheve nga sipërfaqet e gjelbërta dhe bartja deri në deponi të licencuar	8,892 m ²
15	Prerja dhe largimi i drunjve të lartë të cilët paraqesin rrezik, gjatësi deri në 15m	2 copë



6.2 Drejtoria e Arsimit

Gjatë vitit 2023 duke u bazuar në kërkesat e menaxherit të kontratës kemi kryer këto shërbime në institucionet shkollore në komunën e Obiliqit sipas pozicioneve të kontratës:

Nr.	Përshkrimi i pozicionit:	Totali vjetor (2023) në njësi
1	Largimi i mbeturinave nga sipërfaqet e gjelbëruara dhe nga shportat e vendosura në ato sipërfaqe dhe bartja deri në deponi	8,810 m ²
2	Kositja e barit me makina kositëse, grabujimi i barit të kositur dhe bartja deri në deponi	66,161.56 m ²
3	Fshirja dhe larja e kubzave	16,677.36 m ²
4	Krasitja e drunjve dekorativ	75 copë
5	Kositja e barit me sillt (makinë kositëse me penj)	80,061 m ²
6	Trajtimi i hapësirave të kubzave me herbicid total	34,317.16 m ²







6.3 Drejtoria e Shëndetësisë

Gjatë vitit 2023 duke u bazuar në kërkesat e menaxherit të kontratës kemi kryer këto shërbime në QKMF në Obiliq, AMF në Milloshevë, AMF në Breznicë, AMF Siboc, Qendra për Punë Sociale dhe Shtëpia e Pensionistëve sipas pozicioneve të kontratës:

Nr.	Përshkrimi i pozicionit:	Totali vjetor (2023) në njësi
1	Largimi i mbeturinave nga sipërfaqet e gjelbëruara dhe nga shportat e vendosura në ato sipërfaqe dhe bartja deri në deponi	34,330 m ²
2	Kositja e barit me makina kositëse, grabujimi I barit të kositur dhe bartja deri në deponi	31,887 m ²
3	Fshirja dhe larja e kubzave	1,788.48 m ²
4	Krasitja e drunjve dekorativ	
5	Prerja dhe largimi i drunjve të lartë të cilët paraqesin rrezik, gjatësi 15m-30m	9 copë
6	Gëlqerosja e trupit të drunjve dekorativ	104 copë
7	Mirëmbajtja e ulëseve (pastrimi, ngjyrosja me ngjyrë të njëjte me atë ekzistuese, ankerimi), aktivitetet e lartcekura bëhen sipas kërkesës së kontraktuesit.	22 copë
8	Pastrimi i gjetheve nga sipërfaqet e gjelbërta dhe bartja deri në deponi të licencuar	3,266 m ²
9	Trajtimi i hapësirave të kubzave me herbicid total	1,988.48 m ²
10	Largimi i mbeturinave të ndryshme të ngurta dhe dheut johumësor me mekanizëm nga sipërfaqet e planifikuara për gjelbërim dhe barta e tyre deri në deponi, si dhe eliminimi i deponive ilegale	1 ton
11	Saldimi dhe riparimi i terreneve sportive, parqeve, shesheve, lapidarëve dhe objekteve tjera komunale (saldime të rrethojës dhe ankerim), aktivitetet e lartcekura bëhen kërkesës sipas kontraktuesit)	65 m ²




6.4 Drejtoria e Kulturës

Gjatë vitit 2023 duke u bazuar në kërkesat e menaxherit të kontratës nga ana e komunës kemi kryer këto shërbime ne Lapidaret dhe hapësirat qe menaxhon kjo drejtori, sipas pozicioneve të kontratës:

Nr.	Përshkrimi i pozicionit:	Totali vjetor (2023) në njësi
1	Largimi i mbeturinave nga sipërfaqet e gjelbëruara dhe nga shportat e vendosura në ato sipërfaqe dhe bartja deri në deponi	66,518.8 m ²
2	Kositja e barit me makina kositëse, grabujimi I barit të kositur dhe bartja deri në deponi	36,208 m ²
3	Fshirja dhe larja e kubzave	5,115.4 m ²
4	Mirëmbajtja e lapidareve (duke përfshirë larjen dhe pastrimin e lapidarit, mbledhjen e mbeturinave, kositjen e barit fshirjen dhe larjen e kubzave) aktivitete e lartcekura bëhen sipas kërkesës së kontraktuesit.	18,005.9 m ²
5	Kositja e barit me sillt (makinë kositëse me penj)	892 m ²
6	Trajtimi i hapësirave të kubzave me herbicid total	1,294 m ²
7	Përgatitja e terenit të planifikuar duke i shtuar pleh organik furnizimi dhe mbjellja e luleve sezonale-sipas porosisë së menaxherit	240 m ²
8	Ndërrimi I mekanizmit të flamujve (kushineta me sajll)	50 copë
9	Furnizimi dhe vendosja e flamujve	50 copë
10	Angazhimi i punëtorëve fizik për nevoja të ndryshme emergjente dhe punë të jashtëzakonshme.	90 orë





6.5 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave

Gjate vitit 2023 duke u bazuar në kërkesat e menaxherit të kontratës kemi kryer këto shërbime në të gjitha lokacionet e varrezave në tërë territorin e komunës së Obiliqit, sipas pozicioneve të kontratës:

Nr.	Përshkrimi i pozicionit:	Totali vjetor (2023) në njësi
1	Mirëmbajtja e varrezave në tërë territorin e komunës së Obiliqit (në çmim përfshihet largimi i mbeturinave, kositja e barishteve dhe largimi i tyre), punët realizohen në bazë të kërkesës së menaxherit, gjatë realizimit të punëve duhet pasur kujdes në ruajtjen e gurëve (pllakave) të varrezave.	254,612 m ²





6.6 Mirëmbajtja dhe Pastrimi i Objekteve Komunale në Obiliq

Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Mirëmbajtja dhe Pastrimi i Objekteve Komunale në Komunën e Obiliqit) kontrata me nr.01/22 të datës 02.02.2022 dhe kontrata me nr. 02/23 të datës 28.04.2023.

Në këtë kontratë ne si ndërmarrje kemi kryer shërbimet për pastrim në objektet komunale:

- Në hapësirat e brendshme të objektit komunal (inventarin, dyshemënë, tualetet etj),
- Në hapësirat e brendshme të qendrës për punë sociale (inventarin, dyshemënë, tualetet etj),
- Në shtëpinë e pensionistëve (inventarin, dyshemënë, tualetet etj),
- Në bibliotekën e qytetit (inventarin, dyshemënë, tualetet etj).

Në këtë kontratë kemi kryer punë ditore nga ora 07:00 – 15:00 dhe kemi bërë furnizim me material shpenzues higjienik, duke u bazuar në kërkesat e menaxherit të kontratës.



6.7 Ofrimi i Shërbimeve të Receptionit në Objektet Komunale

Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Ofrimi i Shërbimeve të Receptionit në Objektet Komunale) 03-1/22 të datës 09.08.2022 dhe kontrata me nr.03/23 të datës 28.04.2023.

Në këtë kontratë kemi bërë shërbimin e receptionit në baza ditore në objektet komunale:

- Objektin e Komunës,
- Bibliotekën e Qytetit,
- Qendrën për Punë Sociale,
- Shtëpinë e Kulturës “Xhavit Haziri” dhe
- Palestrën Sportive “Adem Jashari”.

Gjatë vitit 2023 me kontratat e lartcekura kemi ofruar shërbime për gjithsej 16,985 orë pune.



6.8 Renovimi i Objekteve Shkollore

Kontratë për Shërbime - (Kontrata "Në Shtëpi") - (Renovimi i Objekteve Shkollore) me nr. 04/23 të datës 01.06.2023.



Në këtë kontratë kemi bërë renovimin e objekteve shkollore më konkretisht renovimin e tualeteve, ngjyrosjen e klasave renovimin e dyshemeve si dhe punë të tjera sipas kësaj kontrate në shkollat si në vijim:

- SHFMU "Dr.Ibrahim Rugova" Mazgit i lartë;
- SHFMU " Dr.Ibrahim Rugova" Mazgit i ulët;
- SHFMU "Pandeli Sotiri" Obiliq i vjetër,

Plemetin;

- SHFMU "Hasan Prishtina" Milloshevë;
- SHFMU "Naim Frashëri" Breznicë;
- SHMLP "Ismajl Dumoshi" Obiliq;
- Gjimnazi "17 Shkurti" Obiliq.





6.9 Mirëmbajtja e Ndrëçimit Publik


Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Mirëmbajtja e ndrëçimit Publik në tërë territorin e komunës së Obiliqit Nr. 05/23 të datës 21.08.2023 si dhe aneks kontratë me nr. 05-1/23 të datës 01.12.2023.

Kontrata në fjalë është lidhur në mesin e muajit gusht mirëpo për shkak të procedurave të furnizimit me materialet e nevojshme implementimi i plotë saj ka filluar në muajin dhjetor për të vazhduar në vitin 2024.

Në këtë kontratë jemi të angazhuar me ekipet tona profesionale për rregullimin dhe mirëmbajtjen e ndrëçimit publik ku në vitin 2023 më konkretisht në muajin dhjetor kemi kryer këto shërbime:

- Identifikimin e prishjeve në teren;
- Ndërrimi i dritave në qytetin e Obiliqit (drita me fuqi 50W, 100W dhe 150W);
- Montimi i siguresave të ndryshme në shtyllat e ndrëçimit publik;
- Shtirjen e kablove të ndryshme aty ku është paraqitur nevoja;
- Lyerjen e shtyllave të ndrëçimit publik





6.10 Dekorimi i qytetit të Obiliqit gjatë Festave të Fundvitit

Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Dekorimi i qytetit të Obiliqit gjatë Festave të Fundvitit me nr. 06/23 datë 26.10.2023.

Në këtë kontratë jemi angazhuar me ekipet tona profesionale për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit ku kemi vendosur bredhin dekorativ, drita dekorative në shtyllat e ndriçimit dhe në drunj, kemi vendosur formën e dhuratës për foto të qytetarëve, janë vendosur topat dekorativ me ndriçim, numri i vitit në ardhje 2024 si dhe drenin me drita dekorative të gjitha këto dekorime janë bërë në Sheshin “Dëshmorët e Kombit” si dhe pjesën e re të sheshit.



6.11 Aktivizimi-Ndezja, Mbikëqyrja dhe Pastrimi i Kaldajave për Ngrohjen e Objekteve Shkollore në Komunën e Obiliqit.

Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Aktivizimi-Ndezja, Mbikëqyrja dhe Pastrimi i Kaldajave për Ngrohjen e Objekteve Shkollore në Komunën e Obiliqit Nr.II-1615 datë 09.11.2023.

Në këtë kontratë ne si ndërmarrje kemi kryer shërbime të rregullta për Aktivizimi-Ndezja, Mbikëqyrja dhe Pastrimi i Kaldajave për Ngrohjen e Objekteve Shkollore baza ditore në objektet shkollore duke u bazuar në kërkesat e Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Obiliqit:

- SHFMU “Naim Frasheri” në Kozaricë
- SHFMU “Pandeli Sotiri” në Obiliq i vjetër,
- SHFMU “Ibrahim Rugova” në Obiliq
- SHFMU “Ibrahim Rugova” në Obiliq - Mazgit i lartë
- SHFMU “Ibrahim Rugova” në Obiliq - Mazgit i ulët,
- SHFMU “Abdurrahman Gërguri” në Dardhishtë,
- SHFMU “Hasan Prishtina” në Milloshevë.

6.12 Mirëmbajtje dhe Pastrimin e Poligonit të Shenjëtarisë Katana

Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve - Mirëmbajtje dhe Pastrimin e Poligonit të Shenjëtarisë Katana me nr. prot. 883/23 datë 08.09.2023.

Në këtë marrëveshje me Poligonin e Shenjëtarisë Katana kemi bërë mirëmbajtjen e të gjithë hapësirave të jashtme sipas kësaj kërkesë:

Nr.	Përshkrimi i pozicionit:	Totali vjetor (2023) në njësi
1	Kositja e barit me makina kositëse, grabujimi i barit të kositur dhe bartja deri në deponi,	990 m ²
2	Fshirja dhe larja e kubzave,	3574 m ²
3	Trajtimi i tyre me herbicid total,	3574 m ²
4	Kositja e barit me sillt (makinë kositëse me penj) dhe	533 m ²
5	Krasitja e drunjve dekorativ	42 copë

7. RAPORTI VJETOR I SEKRETARIT TË NDËRMARRJES

Nga data 01.02.2023 e deri me datë 31.08.2023 Sekretari i ndërmarrjes ka qen i emëruar nga ana e Bordit të ndërmarrjes si ushtrues detyre i Kryeshefit Ekzekutiv pas shkarkimit të ish Kryeshefit me datë. 31.01.2023.

Po ashtu në bashkëpunim me Bordin është punuar në shpalljen e konkursit publik dhe procedurat për rekrutimin e aplikuesve në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtarit Kryesor Financiar pasi Zyrtari Kryesor Financiar ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë me datën 29.12.2023. Procedura e zhvillimit të konkursit janë bërë sipas Ligjit nr 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin nr.06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Ligji Nr.03/L-212 i Punës dhe Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,

Kryeshef Ekzekutiv zgjidhet bazë konkursit publik të datës 30.06.2023 z.Berat Mehmeti, si dhe rekrutimin e ZKF në bazë të konkursit publik të shpallur me 07.08.2023 me nr. protokolli 707/23, ku në këtë pozitë përzgjidhet znj.Arbnore Kajtazi.

Nga data 11.01.2023 e deri me datën 27.12.2023 janë mbajtur gjithsej katërmëdhjetë (14) mbledhje nga Bordi i Drejtorëve ku nga to dymbëdhjetë (12) kanë qenë të rregullta dhe dy (2) të jashtëzakonshme.

Pjesëmarrja aktive në mbledhje të BD, përgatitjet e procesverbaleve të këtyre mbledhjeve.

Miratimin e tri (3) Rregulloreve të reja:

- Rregullore e punës së Bordit të Drejtorëve të NPL "KASTRIOTIT" Sh.A;
- Rregullore mbi mbajtjen e dosjeve personale të punëtorëve NPL "KASTRIOTIT" Sh.A;
- Rregullore për menaxhimin e performancës së punonjësve të NPL "KASTRIOTIT" Sh.A.

Si dhe punimin e të gjitha vendimeve të marra nga ana e Bordit të Drejtorëve. Pjesëmarrja në takimet rregullta të zyrtareve të lartë të ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2023 janë nënshkruar Kontratat në Shtëpi me Komunën e Obiliqit dhe me një operator privat:

- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Mirëmbajtja e Hapësirave Publike) 01/23 datë 28.04.2023. (është tejkaluar shuma)
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Mirëmbajtja dhe Pastrimi i Objekteve Komunale në Komunën e Obiliqit) Nr. 02/23 të datës 28.04.2023.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Ofrimi i Shërbimeve të Recepcionit në Objektet Komunale) Nr. 03/23 të datës 28.04.2023.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - (Renovimi i Objekteve Shkollore) Nr.04/23 të datës 01.06.2023.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Mirëmbajtja e ndriçimit Publik në tërë territorin e komunës së Obiliqit Nr. 05/23 datë 21.08.2023 dhe aneks kontrata me nr. 05-1/23 të datës 01.12.2023
- Marrëveshje për ofrimin e shërbimeve - Mirëmbajtje dhe Pastrimin e Poligonit të Shenjëtarisë Katana, me nr. prot. 883/23 datë 08.09.2023.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Dekorimi i qytetit të Obiliqit Gjatë Festave të Fund Vitit me nr. 06/23 të datës 26.10.2023.
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Aktivizimi-Ndezja, Mbikëqyrja dhe Pastrimi i Kaldajave për Ngrohjen e Objekteve Shkollore në Komunën e Obiliqit me nr. 07/23 të datës 09.11.2023
- Kontratë për Shërbime - (Kontrata “Në Shtëpi”) - Mirëmbajtja e Hapësirave Publike në territorin e komunës së Obiliqit me nr. 08/23 të datës 01.12.2023.

Po ashtu punë tjera vendime për formimin e komisioneve të ndryshme për nevojat e ndërmarrjes, dhe punë tjera nga departamenti i administratës.

8. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË BURIMEVE NJERËZORE

Njësia e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në Rregulloren mbi organizimin dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës nr.09/2021 datë 12.08.2021 të NPL"KASTRIOTI"Sh.A, ka përgatitur raportin e punës për vitin 2023.

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Vendime për pushime vjetore	88
2	Vendime për ditë të lira	0
3	Zëvendësime	6
4	Autorizime	3
5	Vendim për anulim të pushimit vjetor	3
6	Vendim për vazhdim të pushimit vjetor	4
7	Vendim për pushim pa pagesë	5
8	Vendime për kompensim të pushimit vjetor	1
9	Vendim për pushim mjekësor	10
10	Vendime për punë jashtë orarit	63
11	Vendime për ndërprerje të kontratës	5
12	Vendim për sistematizim të përkohshëm	9
13	Vërtetim për bankë	3

Totali i të punësuarve për vitin 2023			
Totali i të punësuarve	janar-dhjetor 2023	Total	
Me kontratë të pa afatizuar	25	25	Format e kontratave
Me kontratë të afatizuar	46	46	
Meshkuj	46	46	Gjinia
Femra	16	16	
Bordi i Drejtorëve	4	4	Njësitë /
Kryeshef ekzekutiv	1	1	
Zyrtar Kryesor Financiar	1	1	
Sekretar i ndërmarrjes	1	1	

Burime njerëzore	2	2	Departamentet
Zyrtar Ligjor	1	1	
Zyrtar Certifikues	1	1	
Arkivist	1	1	
Koordinator	2	2	
Zyrtari i Prokurimit	1	1	
Referent për siguri në punë	1	1	
Njësia për mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese	13	13	
Njësia për mirëmbajtjen e objekteve komunale (Pastrimi)	9	9	
Njësia e Receptionsit	7	7	
Depoist	1	1	
Suvatues	2	2	
Elektracist	4	4	
Shofer B	1	1	
Shofer C	3	3	
Punëtor i Autoparkut	1	1	
Axhustator	1	1	
Sigurim	4	4	
Total punëtorë	62	62	

9. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRTARIT LIGJOR

Në kuadër të skemës organizative të ndërmarrjes zyra ligjore e ushtron funksionin e saj në kuadër të Administratës së përgjithshme. Që nga data 05.06.2023 zyra ligjore është funksionalizuar në kuadër të ofrimit të shërbimeve duke ofruar interpretime ligjore për departamentet tjera të ndërmarrjes.

Që nga periudha 05.06.2023 - 31.12.2023 në pozitën e zyrtarit ligjore kam vepruar konform dispozitave ligjore kam dhënë interpretime ligjore.

Me datë 12.06.2023 me vendim nga u.d. Kryeshefi Ekzekutiv jam emëruar Kryetar i komisionit për amandamentimin e rregulloreve:

- Rregullore për rregullimin e marrëdhënies së punës
- Rregullore për sistematizimin e vendeve të punës
- Rregullore e reprezentacionit

Nga pozita e zyrtarit ligjor mbaj edhe procesverbalin e mbledhjeve të menaxhmentit të lartë. Në kuadër të përgjegjësive ligjore që kam si zyrtar kam vazhduar me përgatitjen e akteve administrative – vendimeve për emërim të menaxherëve të kontratave, si dhe vendime të ndryshme në bazë të kërkesave nga departamentet gjegjëse.

Në vazhdim do të paraqes aktivitetet dhe punën e bërë nga pozita e zyrtarit ligjor bazuar në raportin e punës.

Krijimi i komisioneve punuese në kuadërtë ndërmarrjes	6 komisione
Autorizim për ushtrim të funksionit deri në kthimin nga pushhimi	5 autorizime
Procesverbal i mbledhjeve të menaxhmentit të lartë të NPL”Kastrioti”Sh.A	23 procesverbale
Kërkesa drejtuar institucioneve publike lokale	5 kërkesa
Vendime të ndryshme (akte administrative, akte juridike,)	177 vendime
Plotësim ndryshim i rregullorës	1 plotësim ndryshim i rregullorës
Procedurë të plotësim ndryshim të rregulloreve	3 rregullore në proces të plotësim ndryshimit
Kontrata të punës	34 kontrata pune

10. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS PËR PROKURIM

Zyra e Prokurimit në vitin 2023 ka udhëhequr gjithsej 19 lëndë ku do të paraqiten si në tabelen në vijim:

Nr.	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	Çmimi i kontratës me TVSH	Data e nënshkrimit të kontratës	Data e përfundimit të kontratës	Statusi
1	Shërbime-Programi i kontabilitetit dhe mirëmbajtja	NAVIGATOR L.L.C.	770.00 €	12.01.2023	12.01.2024	Përfunduar
2	Shërbime-Funksionalizim dhe dizajnim i Webfaqes zyrtare	GETNO L.L.C.	500.00 €	12.01.2023	12.01.2024	Përfunduar
3	Shërbime - Auditim i pasqyrave financiare	Quatra Audit Int L.L.C.	940.00 €	12.01.2023	30.04.2024	Përfunduar
4	Furnizim me Material Administrativ	SIA TECH L.L.C.	979.80 €	24.01.2023	24.01.2024	Përfunduar
5	Furnizim me material higjienik	" KIGA " SH.P.K.	1,991.38 €	03.02.2023	03.02.2024	Përfunduar
6	Shërbime Përgatitje, Nënshkrim dhe Certifikim te Pasqyrave financiare për vitin 2022	ZETA Advisory Services L.L.C.	500.00 €	27.02.2023	31.03.2023	Përfunduar
7	Furnizim me uniforma	" Sankos " Sh.p.k.	4,118.20 €	10.05.2023	09.05.2024	Përfunduar
8	Furnizim me material shpenzues (Kosa, Trimer)	JON GROUP L.L.C.	3,050.01 €	28.04.2023	27.04.2024	Përfunduar
9	Furnizim me kosa dhe tremera	JON GROUP L.L.C.	9,791.60 €	28.04.2023	27.04.2024	Përfunduar
10	Furnizimi i materialit për renovimin e objekteve Shkollore në Komunën e Obiliqit	GLOBAL ING SH.P.K.	13,785.00 €	26.07.2023	25.08.2023	Përfunduar
11	Shërbime të telekomunikimit për N.P.L Kastrioti Sh.A	IPKO	780.00 €	09.08.2023	08.09.2024	Aktive (vazhdon)

12	Furnizim me fshisa elektrike për NPL Kastrioti Sh.A	Comet SH.P.K.	990.00 €	06.10.2023	06.11.2023	Përfunduar
13	Furnizim me material hixhienik për nevoja te NPL Kastrioti Sh.A	DEMOS SH.P.K.	996.50 €	20.10.2023	19.11.2023	Përfunduar
14	Furnizimi me material Elektrik për nevojat e N.P.L Kastrioti Sh.A	Comet SH.P.K.	995.10 €	23.10.2023	22.11.2023	Përfunduar
15	Furnizimi me drita dhe pajisje përcjellëse për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në tërë territorin e Komunës së Obiliqit sipas kontratave 05/23	"Item EL" SH.P.K.	30,000.00 €	27.11.2023	26.11.2024	Aktive (vazhdon)
16	Furnizim me aparate të punës për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A	AGRION SH.P.K.	993.00 €	06.12.2023	20.12.2023	Përfunduar
17	Furnizim me çizme sigurie për punëtorë të NPL Kastrioti sh.a	Komtel Project Engineering SH.P.K.	885.00 €	07.12.2023	21.12.2023	Përfunduar
18	Furnizimi me produkte dhe pajisje për dekorimin e Qytetit për festat e fundvitit 2023	FINESË DESIGN SH.P.K.	31,930.00 €	07.12.2023	21.12.2023	Përfunduar
19	Marrja me qira e makinerisë korpë dhe makinerisë kran për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A	" AR- AM- ING " SH.P.K.	19,990.00 €	29.12.2023	28.06.2024	Aktive (vazhdon)
VLERA TOTALE:			123,985.59 €			

11. RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN FISKAL 2023

Pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe është pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Përmes këtij raporti konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit përveç llogarisë bankare të specifikuarë në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2023.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huatë e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi.
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023.

11.1 Pasqyra e arkëtimit të të hyrave nga shërbimet Janar – Dhjetor 2023

Pasqyra e arkëtimit të të hyrave nga shërbimet paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 1: Të hyrat për periudhën Janar-Dhjetor 2023

(Të gjithë vlerat janë prezantuar pa TVSH)

NR.	TË HYRAT:	2023
1.	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit	88,988.29 €
2.	Drejtoria e Administratës - Mirëmbajtje e objekteve komunale (Pastrim)	44,945.04 €
3.	Drejtoria e shërbimeve publike: shërbimi i Receptonit, mirëmbajtje e varrezave, Ndriçimi Publik	140,068.20 €
4.	Drejtoria e Arsimit	73,584.36 €
5.	Drejtoria e Shëndetësisë	6,331.46 €
6.	Drejtoria e Kulturës dhe Sportit	69,216.25 €
7.	Kontrata me Posta e Kosovës Sh.A.	1,521.61 €
8.	Poiligoni i shenjëtarisë "Katana"	1,358.90 €
9.	Donacionet	3,450.00 €
10.	Të hyrat e shtyera	30,000.00 €
	TOTALI	459,464.11 €

11.2 Pasqyra e shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2023

Pasqyra e shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2023 paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 2: Pasqyra e shpenzimeve Janar-Dhjetor 2023

(Të gjithë vlerat janë prezantuar pa TVSH)

Nr.	EMËRTIMI	2023
	Shpenzimet e Personelit	355,523.34 €
1	Shpenzimet e të ardhurave personale	302,250.33 €
2	Shpenzimet e kontributeve të punëdhënësit	53,273.01 €
	Kostoja e Mallit të shitur	44.747.65 €
1	Kosto e materialit shpenzues operativ	42,087.27 €
2	Kosta e materialit higjienik	2,660.38 €
	Shpenzimet Administrative / Operative	
1	Shpenzimet e Derivateve	5,289.00 €

2	Shpenzimet Profesionale Juridike Financiare	3,031.14 €
3	Shpenzimet e anëtarësimeve dhe licenca	1,200.00 €
4	Shpenzime e Internetit dhe Telefon	628.42 €
5	Shpenzimet për bartje të mbeturinave & Shpenzimet Komunalive	1,330.00 €
6	Shpenzimet e provizioneve bankare	468.55 €
7	Shpenzimet e reprezentacionit	153.64 €
8	Shpenzime Material Higjienik	116.38 €
9	Shpenzimet e Zyrës dhe Administratës	1,538.49 €
10	Shpenzime për Operativë	7,402.97 €
11	Shpenzimet e mirëmbajtjes se zyrës	1,482.92 €
12	Shpenzimet e Ujit	175.93 €
13	Shpenzime për Lëndime dhe Sëmundje Profesionale të Shkaktuara në Punë	2,300.00 €
14	Shpenzimet Operative - Elektros	11,682.20 €
15	Shpenzimet e Aseteve te Vogla	11,870.00 €
16	Shpenzimet e Automjeteve	206.78 €
	Total i shpenzimeve	48,876.42 €
IV	Shpenzimet Tjera Tatimore	873.83 €
	GJITHSEJT I+II+III+IV	450,021.24 €

PËRFUNDIM

Ndërmarrja Publike Lokale “Kastrioti” Sh.A, gjatë vitit 2023 ka treguar një performancë të mirë në përputhje me planin e biznesit dhe buxhetit për vitin 2023.

Duke pasur parasysh që ne si ndërmarrje jemi në fazën e konsolidimit si për nga stafi ashtu edhe për nga mjetet dhe makineritë e punës është e nevojshme përkrahja e aksionarit në vazhdimësi.

Propozojmë që Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit të planifikoj buxhet shtesë që të na furnizoj me mekanizim modern në mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe ngritjen e sipërfaqeve gjelbëruese gjithmonë duke u mbështetur në Statut, me detyrat dhe obligimet që i kemi si Ndërmarrje.


Berat Mehmeti

Kryeshef Ekzekutiv



Arbnore Kajtazi

Zyrtar Kryesor Financiar



Flakron Mjekiqi

Sekretar

